

## SHENIMET SHPJEGUESE

KETO PASQYRA JANE PERPILUAR NE ZBATIM TE SKK

### SHENIMET SHPJEGUESE

#### Sqarim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas Urdhërimit të Ministrisë së Financave, Nr. 62 Datë 17.09.2015 "Per Shpalljen e Standartit Kombëtar të Kontabilitetit dhe Zbatimin e Standartit Kombëtar të Kontabilitetit në Q.F. dhe Zbatimin e Standartit Kombëtar të Kontabilitetit në Sektorin e Tregtisë dhe Shërbimeve".  
Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte të percaktuara në SKK 2 dhe konkretisht paragrafeve 49-55. Rradha e

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
- b) Shënimeve që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënime të tjera shpjeguese

#### A I Informacion i përgjithshëm

- 1 Kuadri ligjor: Ligji 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- 2 Kuadri kontabel i aplikuar : Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.
- 3 Baza e pergatitjes se PF : Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.
- 4 Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per hartimin e P.F. :
  - a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUSE ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet, pasivet dhe transakcionet ekonomike te veta.
  - b) VIJIMESIA e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuse eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevojë nderprerjen e aktivitetit te saj.
  - c) KOMPENSIM midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka , ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
  - d) KUPTUESHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote per te qene te qarta dhe te kuptueshme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjitheshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
  - e) MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.
  - f) BESUESHMERIA per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhteme :
    - Parimin e paraqitjes me besnikeri
    - Parimin e perparësise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
    - Parimin e paaneshmerise pa asnje influencim te qellimshem
    - Parimin e maturise pa optimizem te tepruar, pa nen e mbivleresim te qellimshem
    - Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
    - Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
    - Parimin e krahasueshmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

#### A II Politikat kontabël

Per percaktimin e koston se inventareve eshte zgjedhur metoda "FIFO" ( hyrje e pare , dalje e pare.

Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me kosto.

Blerja dhe krijimi i AAM gjate periudhes ushtrimore eshte financuar nga veprimtaria rrjedhese e shoqerise, dhe vleresimi eshte bere koston faktike.

Per vleresimi i mepaseshem i AAM eshte zgjedhur modeli i koston duke i paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar.

Per llogaritjen e amortizimit te AAM (SKK 5: 38) njesia jone ekonomike ka percaktuar si metode te amortizimit per AAM qe ka ne pronesi te saj metodën e amortizimit mbi bazen e vleres se mbetur ndersa normat e amortizimit jane perdorur te njellojta me ato te sistemit fiskal ne fuqi dhe konkretisht :

- Per ndertesat ne menyre lineare me 5 % ne vit.
- Kompjuterat e sisteme informacioni me 25 % te vlefes se mbetur
- Te gjitha AAM te tjera me 20 % te vlefes se mbetur

Per llogaritjen e amortizimit te AAJM (SKK 5: 59) njesia ekonomike raportuese ka percaktuar si metode te amortizimit metodën lineare ndersa normen e amortizimit me 15 % ne vit.

ADMINISTRATORI

BESNIK CULLAJ

PERPILUESI I PF

ZYRIE GJYMISHKA

